

AKT THEMELIMI
DHE
STATUTI I SHOQERISE
"ESCOOH AL" SH.P.K

Sot me date 07.03.2019 ,

une ANTONIO RIZZUTO, atesia (GAETANO), shtetas italian, lindur me 11.11.1974, ne FAVARA (AG) , Itali dhe banues ne FAVARA (AG), madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA1101405


bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakut themelues si dhe ne vullnetin tim te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kam hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA
NENI. 1
DATA E THEMELIT, EMRI I THEMELUESIT

1. Sot ne date 07.03.2019, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin "ESCOOH AL " SH.P.K
2. Themelues i shoqerise eshte:
 - ANTONIO RIZZUTO , atesia (GAETANO), shtetas italian, lindur me 11.11.1974, ne FAVARA (AG), Itali dhe banues ne FAVARA (AG) .madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA1101405

NENI. 2
OBJEKTI I SHOQERISE
Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

1. Shoqeria do te ndermare aktivitetete te ndryshme ne lidhje me krijimin,prodhimin,shperndarjen si dhe shitjen e produkteve dhe prodhimeve te drurit, mobilje, kuzhina, pjese kuzhinash, aksesore te tyre, dyer dhe dritare druri, parkete te ndryshme si dhe produkte te tjera qe kane permbajtje druri dhe qe lidhen me aktivitetin e mesiperme te shoqerise.
2. Aktivitete te kerkim-zhvillimit , baze ose te aplikuara mbi materialet natyrale, mbi design, mbi ergonomine , finiturat dhe mbi funksionalitetin e tyre, mbi mobiljet e kuzhines ose pjese te vecanta te kuzhines,zhvillimin e fazave te ndryshme te



- projektimit, inxhinjerimit, krijimin e prototipeve te komponenteve , aksesoreve te ndryshem dhe te tjera te lidhur me aktivitetin kryesor te kompanise
3. Ndertim te objekteve te ndryshme industriale, social-kulturore, civile dhe jo civile, ndertim te infrastruktures, ndertim te apartamenteve dhe te vilave te banimit, te kanalizimeve dhe te ujesjellsave, rrugeve etj, prodhime te materialeve te ndertimit, ndertim rehabilitim dhe rikonstruksion te ndertimeve civile dhe jo civile, import eksport te materialeve ndertimore makinerive dhe gjithë produkteve ne funksion te aktivitetit ndertimor.
 4. Projektim, studim, supervizim i punimeve te ndryshme te ndertimit civile dhe jo civile.
 5. Prodhim, perpunim, nxjerrje materiale inerte dhe beton, transport dhe tregetim i tyre brenda dhe jashte vendit, import eksport i tyre dhe i gjithë makinerive ne funksion te aktivitetit te nxjerrjes dhe perpunimit te inerteve.
 6. Germime dhe transport materiale ndertimi, Prodhim dhe furnizim betoni.
 7. Tregtimin me pakice dhe me shumice te materialeve hidraulike dhe termike,projketimin ndertimin, instalimin,montimin si dhe mirembajtjen dhe riparimin e impianteve te ajrit te kondicionuar, ngrohjes termo-teknike dhe impianteve te gazit, impianteve elektrike, si dhe tregtimin, importimin dhe eksportet perkatese
 8. Shitjen me pakice dhe me shumice te pajisjeve per instalimin, montimin dhe riparimin e impianteve pershkruara me lart
 9. Ndertimin e tubacioneve per transportin e gazit dhe te ndryshme, duke perfshire edhe ndertimin e veprave te artit, germimet dhe ndedrtimin e rrugeve.
 10. Shitjen me pakice dhe me shumice te bojrave, pajisjeve per punime me dore , materialeve hidrosanitare dhe termo sanitare, materialeve te ndryshme per ndertimin (te tilla si dysheme veshje muri) dhe pajisjet e lidhura, ne vecanti materiale qeramike, mobilie per banjo, rubinet dhe hidrosanitare, pajisje elektronike te telefonise dhe telekominikacionit.
 11. Shitja e mobilieve te montuara dhe te pamontuara, elektro-shtepiake dhe bombola gazi.
 12. Blerjen dhe shitjen, shkembimin , projektimin, ndertimin, shembjen, mirembajtjen, dhe menaxhimin edhe me koncesion, rikualifikimin, dhenien me qera te tokes, ndertesave dhe pasurive te paluajtshme te gjitha llojeve , te ndertesave dhe veprave civile, te ndertimeve ne pergjithesi, uzinave te prodhimit, hoteleve dhe strukturave pritesë dhe tregtare , impianteve dhe ose komplekseve industriale, impianteve te prodhimit te energjise dhe impianteve teknologjike ne pergjithesi,
 13. Realizimin e veprave te mesiperme si kontraktor i vetem ose kryesor.
 14. Ekzekutimin e kontratave per aktivitetet e mesiperme, duke perfshire ofrimin e sherbimeve, prodhimin marketing dhe shitjen per llogari te vet ose per llogarine e te treteve te energjise ne format e saj te ndryshme, te titujve te energjise dhe te sherbimeve te



- integruara ne fushen e energjise per qellim kursimin dhe optimizimin (menaxhimin e energjise);
15. Prodhimin e energjise elektrike dhe energjise ne pergjithesi, tregtimin e energjise elektrike dhe energjise ne pergjithesi, marketingun e produkteve te energjise, shitblerjen e titujve te energjise te tilla si certifikata te gjelbra, certifikatat e bardha dhe te tjera si keto; sherbimet per menaxhimin dhe mirembajtjen e impianteve me koncesion, prodhimin dhe shperndarjen e energjise permes shoqerive te sherbimit ne fushen e energjise.
 16. Sherbimet e integruara per realizimin dhe eventualisht menaxhimin e nderhyrjeve te gjitha llojeve, ne fushen e energjise.
 17. Prodhimin dhe shitjen e software
 18. Cdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme dhe hipotekore qe lidhen me to, operacione financiare dhe kredimarrje, te jape garanci te treteve si edhe te bleje dhe shese ose marre me qera ndermarrje, dege ndermarrjesh, si edhe te kete pjesemarrje ne shoqeri, ente, konsorciume, te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise.
 19. Konsulence te pergjithshme.
 20. Blerje, shitje, madje edhe fraksionimi, ristrukturimi dhe projektim, te gjitha aktivitetet e vleresimit te pasurive te patundshme ne pergjithesi, si urbane edhe rustike, per perdorim tregtar, industrial, rezidencial dhe zyra, dhe ekspertizat e vleresimit e tyre, dhënia me qira dhe menaxhimin i pasurive te paluajtshme.
 21. Realizimi i Punimeve te ndertimit ne pergjithesi, punime te rrugeve perfshire germimet, shkaterrimet, ndertimi i ujesjellesave, kanalizimeve dhe te ngjashme me to.
 22. Investimi ne tregun e ndertimit, blerje, administrim, shitje te pasurive te paluajtshme Real Estate.
 23. Tregtim me shumice dhe pakice, Import eksport te produkteve, materialeve te ndertimit dhe makinerive te ndryshme te domosdoshme per ushtrimin e aktivitetit perfshire produktet bujqesore dhe ushqimore ne teresi.
 24. Ushtrimi i aktivitetit brenda dhe jashte Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin.
 25. Cdo aktivitet tjeter te lidhur me aktivitetin kryesor

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar
Shoqeria mund te priset perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.



NENI. 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise .eshte ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit "Kullat Binjake" kati 2, nr. 26 Tirane.

KREU II

KAPITALI

NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 1000 (njemije) leke i perbere nga nje kuote.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet ne masen 100% (1 kuote me vlere nominale te kuotes 1000 leke) nga Ortaku:

- ANTONIO RIZZUTO , atesia (GAETANO), shtetas italian, lindur me 11.11.1974, ne FAVARA (AG), Itali dhe banues ne FAVARA (AG) .madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA1101405 zoteron 100 % te kapitalit te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.


Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.
Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI. 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise



- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.
Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE
NENI. 8

ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimares i shoqerise.
Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi, i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjitha ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjitha ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullslse.



NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperme nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES


Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13

ADMINISTRIMI



Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertesitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

- ANTONIO RIZZUTO , atesia (GAETANO), shtetas italian, lindur me 11.11.1974, ne FAVARA (AG), Itali dhe banues ne FAVARA (AG) .madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA1101405

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikaten tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise d) PergatIsIn dhe nenshkruajne bilancIn vjetor, bilancIn e konsoliduar dhe raportIn e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregulloret e tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate admInIstrImIt te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprIme ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.



2. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV
VITI FINANCIAR -EKSPERTET
NENI 16
VITI FINANCIAR

Viti finaciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5
PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE
NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

ART. 20
KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT



Ortakët dhe administratoret e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jenë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën. Ndalimi i pikës 1 mund të anulohet në asamblenë e parë të përgjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave në sipas dispozitave të nenëve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 22

MOSMARRVESHJET

Për mosmarrveshjet midis ortakëve të shoqërisë, ose shoqërisë me të tretet, gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua në 4 kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italyane, me vlerë të njëjta ligjore.

ORTAKU THEMELUES

ANTHAW RIZOVU
